



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E LIPLJANIT OPŠTINA LIPLJAN			
PRANUAR MË: PRIMLJENO DANA:		09.02.2026	
NJËSIA JEDINICA	NR. KLASIFIKIMIT BR. KLASIFIKACIJE	NR. LËNDËS BR. PREDMETA	SHTOJÇA PRILOG
04-	020/04-7376		



KOMUNA E LIPLJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPLJAN

Në mbështetje të nenit 62 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve nr. MF04/2017, si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Drejtori i DKA-së shpall

**NJOFTIM PUBLIK
PËR DËRGIMIN E PROPOZIMEVE PËR ANËTAR NË KOMISIONIN VLERËSUES PËR
FINANCIMIN E PROJEKTEVE TË OJQ-VE**

Njoftohen përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile se mund t'i dërgojnë propozimet e tyre për plotësimin e Komisionit Vlerësues i cili do të formohet me qëllim të vlerësimit të aplikacioneve për financimin e projekteve të OJQ-ve, të cilat do të aplikojnë sipas thirrjes publike për aplikim me Nr.04-453/01-6476, të datës 04.02.2026.

Ky Komision do të formohet me qëllim të vlerësimit të aplikacioneve për financimin e projekteve të OJQ-ve: "Që drejtojnë qendra mësimore që mbështesin nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe nxënës të tjerë që kontribuojnë në arritjen arsimore", ku do të plotësohet me:

- Një përfaqësues nga OJQ-të
- Një përfaqësues nga shoqëria civile në cilësinë e ekspertit

Propozimet tuaja do të jenë të mirëpritura dhe duhet t'i drejtohen DKA-së dhe të njëjtat të dorëzohen në ndërtesën e Komunës, kati I-rë, në Qendrën për Shërbime me Qytetarë, sporteli nr. 1 dhe 2, më së largu deri më datë 13.02.2026.

Lipjan, 09.02.2026

